



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

# **RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2021**

*Departamenti i Mjekësisë Sociale  
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*



**RAPORTI I GJENDJES  
PERINATALE NË KOSOVË PËR  
VITIN 2021**

*Departamenti i Mjekësisë Sociale  
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKShPK*

**Botuesi:**

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

Copyright:

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

## Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2021” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Të dhënat të cilat i shfrytëzojmë për përgatitjen e Raportit të Gjendjes Perinatale nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës edhe për vitin 2021 janë të mangëta, si për Statistikat e Lindjeve dhe Statistikat e vdekjeve, andaj kemi prezentuar lindjet sipas të dhënave nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, dhe të dhënat në dispozicion nga ASK.

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2021. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private. Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes. Foshnjat e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës. Koeficienti i vdekshmërisë infantile është prezentuar sipas komunave, kurse koeficienti perinatal në mungesë të dhënave është prezentuar vetëm sipas vitit.

Duke pasë parasysh mangësitë në burime relevante të të dhënave lexuesit dhe ata të cilët do të përdorin këtë hulumtim këshillohen që të marrin me rezervë vlerat e fituara të indikatorëve sepse nuk ilustrojnë në mënyrë të denjë realitetin e gjendjes perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domosdoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD. C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

# PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA .....	6
PËRMBLEDHJE .....	7
DEFINICIONET .....	8
METODOLOGJIA .....	10
TË DHËNAT KRYESORE .....	122
LINDJET.....	134
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	23
VDEKSHMËRIA FETALE.....	277
VDEKSHMËRIA PERINATALE .....	29
PËRFUNDIMET .....	31
REKOMANDIMET .....	33
BIBLIOGRAFIA .....	35
ANEX .....	36

## **PËRMBLEDHJE**

Në vitin 2021, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,830 foshnje të lindur gjallë, prej tyre 478 jashtë Kosovës. Krahasuar me vitin paraprak (21,907) dallimi i të lindurve gjallë është 923 të lindur gjallë më shumë në vitin 2021.

Sipas Departamentit të Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) në vitin 2021 janë raportuar gjithsej: 20,654 lindje (lehona), foshnje të lindura 21,005; të lindur gjallë 20,889 dhe 116 të lindur vdekur.

Në institucionet shëndetësore në vitin 2021 nga gjithsej lindje, 26.5% të lindjeve janë realizuar me prerje cezariane.

Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj është e paraparë edhe në objektvën e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport i dedikohet vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë me qëllim të identifikimit të situatës, monitorimit të vazhdueshëm si dhe planifikimit të masave specifike adekuate në adresimin e problemeve rreth shëndetit perinatal.

## DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit. Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKShPK dhe UNICEF-i.

**I lindur** nënkupton shkëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

**I lindur gjallë** nënkupton shkëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptcionit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

**I lindur vdekur:** Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptcionit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

### **Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)**

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes. Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 500$  g ose  $\geq 22$  javë). Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ( $\geq 1,000$  g ose  $\geq 28$  javë).

### **Shkalla e vdekshmërisë perinatale**

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

**Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal)** definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.



**Vdekjet neonatale** (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

- **vdekjet e hershme neonatale**, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës,
- **vdekjet e vonshme neonatale** që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

**Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)**

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

**Shkalla e vdekshmërisë maternale** paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

**Vdekje e vonshme maternale** është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

## METODOLOGJIA

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2021 nga ASK-së për statistikat vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. IKShPK, gjegjësisht Departamenti i Statistikave Shëndetësore, grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bën raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve bënë analizën e indikatorëve të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante e realizon Departamenti i statistikave shëndetësore në IKShPK, kalkulimin e indikatorëve të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve.

## **Sfidat për grumbullimin e të dhënave:**

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sfida është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKShPK).
- Gjatë vitit 2019/2020 është punuar në unifikimin e formularit për raportim, megjithatë të dhënat nga ASK për vitin 2021 për lindje dhe vdekje nuk janë të kompletuara edhe pas publikimit të fundit, prandaj në raportin e gjendjes Perinatale për vitin 2021, në mungesë të të dhënave disa indikatorë të agreguar kanë diskrepancë krahasuar me vitet paraprake si dhe disa indikatorë tjerë nuk kemi pasë mundësi t'i kalkulojmë sipas gjinisë dhe komunave.
- Përkundër ekzistimit të qarkores në fuqi për raportim të vdekjeve maternale, si dhe kërkesës së vazhdueshme për raportim edhe në vitin 2021 asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore. Në vitin 2021 në mungesë të dhënave nuk ka reflektim të këtij indikatorit në Raportin Perinatal.
- Përfshirja në raportim e vdekjeve fetale sipas komunave të Kosovës është sfida tjetër për tu adresuar.
- Mungesa e analizimit të Shkaqeve të vdekjeve për vitin 2021 në nivel nacional për arsye të vonësës së publikimit gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.
- Në Raportin Perinatal për vitin 2021 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazikë dhe vazhdon të mbetet sfida për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit European EURO-PERISTAT.

## TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2021 në Kosovë, të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private në Departamentin e Statistikave Shëndetësore - IKShPK janë:

- 20,654, lindje (lehona)
- 21,005, foshnje të lindura
- 20,889 të posalindur gjallë
- 116 të lindur vdekur
- raporti gjinor në lindje është 1078.7 meshkuj në 1,000 femra
- shkalla e lindjeve me prerje cezariane është 26.5 % .

**Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2021**

<b>Nr</b>	<b>Modalitetet</b>	<b>2021</b>
<b>1</b>	Numri i lindjeve	<b>20,654</b>
<b>2</b>	Foshnje të lindura	<b>21,005</b>
<b>3</b>	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë	<b>22,889</b>
<b>4</b>	Numri i vdekjeve fetale	<b>116</b>
	Numri i foshnjave të vdekura (<1 vjet)	<b>100</b>
<b>5</b>	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	<b>5.1</b>
<b>6</b>	Shkalla e vdekshmërisë infantile (‰)	<b>4.4</b>
<b>7</b>	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	<b>64</b>
<b>8</b>	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	<b>2.8</b>
<b>9</b>	Shkalla e mortalitetit të vonshëm neonatal (‰)	<b>0.7</b>
<b>10</b>	Shkalla e mortalitetit post neonatal (‰)	<b>0.8</b>
<b>11</b>	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	<b>7.9</b>
<b>12</b>	*Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (‰)	<b>26.5</b>

Burimi: ASK- Statistikat e lindjeve, vdekjeve, 2021

IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës, 2021

**Tab.2.Të dhënat kryesore perinatale për periudhën, 2000-2021**

Vitet	Të dhënat kryesore perinatale, 2000-2021							
	Numri i lindjeve	Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	Numri i vdekjeve fetale	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	Shkalla e vdekshmërisë së perinatale (‰)	Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (%)
2000	39,091	38,907	572	14.5	577	14.8	29.1	7.5
2001	39,578	39,506	579	14.4	574	14.5	28.7	9.1
2002	35,399	35,271	527	14.7	444	12.6	27.1	10.3
2003	31,932	31,815	517	15.9	375	11.8	27.6	11.3
2004	30,925	30,852	452	14.4	352	11.4	25.6	12.3
2005	29,056	29,055	390	13.3	262	9.02	22.1	13.9
2006	28,404	28,450	360	12.5	307	10.8	23.2	16.4
2007	27,856	27,972	319	11.3	247	8.8	20.0	17.7
2008	28,178	28,317	334	11.6	257	9.1	20.6	18.2
2009	27,718	27,833	276	9.8	267	9.6	19.3	20.1
2010	27,517	27,645	318	11.4	216	7.8	19.1	20.7
2011	27,548	27,725	252	9.0	248	8.9	17.9	21.8
2012	28,525	28,664	284	9.8	218	7.6	17.3	20.9
2013	27,069	27,277	278	10.1	170	6.2	16.3	25.2
2014	26,565	26,787	226	8.4	98	3.7	12.0	26.9
2015	24,611	24,812	177	7.1	126	5.0	12.1	27.3
2016	24,092	24,697	156	6.3	121	4.9	11.2	24.3
2017	23,563	23,402	161	6.8	132	5.6	12.4	19.0
2018	22,870	22,761	109	4.8	147	6.6	11.2	18.2
2019	21,899	21,798	101	4.6	118	5.4	10.0	20.7
2020	20,781	20,988	135	6.4	43	1.9	8.0	21.0
2021	20,654	22,830	116	5.1	64	2.8	7.9	26.5

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale 2010

ASK: Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2011-2021

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, Statistikat e lindjeve

## LINDJET

Në vitin 2021, sipas të dhënave të ASK-së, janë raportuar gjithsej 22,830 të lindur gjallë, prej tyre 478 të lindur jashtë Kosovës, të lindur vdekur nuk janë raportuar.

Sipas IKShPK-së janë raportuar gjithsej 20,654 lindje (lehona), 20,889 të lindur gjallë dhe 116 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. Diferenca e numrit të të lindurve gjallë të raportuar nga ASK dhe IKShPK për vitin 2021 është 1,941 të lindur gjallë, (tab.3).

**Tab.3. Raportimi i të dhënave nga dy burime të të dhënave**

Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKShPK	20,654	20,889	116
ASK	-	22,830	-
Diferenca		1,941	


Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021  
ASK-Statistikat e Lindjeve 2021

Bazuar në raportin e IKShPK- së, për vitin 2021 gjithsej lindje ishin 20,654, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor ku janë kryer lindjet janë si në vijim: Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 11,184 apo 46.5%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,732 lindje apo 42.3%, në maternitete 135 lindje apo 0.7%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 603 lindje apo 2.9%. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 20,051 apo 97.1% e lindjeve, (tab.4, graf.1).

**Tab.4. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2021**

Istitucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Foshnje të lindura		Të lindur gjallë		Të lindur pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	8,732	42.3	8,970	42.7	8,882	42.5	88	75.9
Spitali	11,184	46.5	11,284	53.7	20,140	53.9	26	21.6
Maternitetet jashtëspitalore	135	0.7	136	0.6	134	0.6	2	1.7
Institucione publike	20,051	97.1	20,390	97.1	20,274	97.1	116	100.0
Institucione private	603	2.9	615	2.9	615	2.9	0	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>20,654</b>	<b>100.0</b>	<b>21,005</b>	<b>100.0</b>	<b>20,889</b>	<b>100.0</b>	<b>116</b>	<b>100.0</b>

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021




**Graf.1** Struktura e lindjeve në institucionet publike dhe private, 2021

**Tab.5** Të lindurit gjallë sipas gjinisë, shkalla e maskulinitetit

Institucioni	Gjinia				TOTALI		Shkalla e maskulinitetit në 1000
	Djem		Vajza		N	%	
	N	%	N	%			
TOTALI	10,840	51.9	10,049	48.1	20,889	100.0	1078.7

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021




**Graf.2.** Struktura e të lindurve gjallë sipas gjinisë

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021

Sipas të dhënave nga Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021 gjithsej ishin 20,889 të lindur të gjallë prej tyre, femra 10,049 (48.1%), meshkuj 10,840 (51.9%) me koeficient të maskulinitetit në lindje 1078.7‰, (tab.5, graf.2).

Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,780 apo (12.2%) komunën e Prizrenit me 1,989 apo (8.7%) dhe komunën e Ferizajit me 1,523 apo (6.7%). Komunat me numrin më të vogël të të lindurve gjallë ishin komuna e Ranillugës me 27 (0.1%), Kllokoti 30 apo (0.1%), Parteshi 33 apo (0.1%), (graf.3).




**Graf.3. Struktura e të lindurve gjallë sipas komunave, 2021**

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2021

## Trendi i lindjeve

Trendi i lindjeve për periudhën kohore 2000-2021 tregon ecuri të rënies së numrit të lindjeve me lëvizje variabile me mesatare 0.862, (graf.4).




**Graf.4. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2021**

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë



## Trendi i natalitetit


Lindshmëria gjatë viteve 2000-2021 tregon trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare 0.8%. Lindshmëria për 1,000 banorë apo nataliteti në vitin 2000 ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2021 ishte 12.9 %, (graf.5).



**Graf.5. Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2021**

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë

Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 23.9 lindje, pason Prizreni me 8.0 lindje, Gjakova me 4.8 lindje dhe më së paku lindje në Vushtrri me 1 lindje në ditë, (graf.6).



**Graf.6. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore**


Burimi: IKShPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021

Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2500-3999g me 86.9 % dhe grup pesha 4000+g me 8.0 %. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.5%. Pesha mesatare e të posalindurve gjallë ishte 3291.2 gram, (tab.6, graf.7).

**Tab.6. Numri i foshnjave të lindura gjallë sipas peshës trupore në institucionet publike dhe private, në vitin 2021**

Të lindur gjallë		Pesha trupore (gr)					Gjithsej	Pesha mesatare
		Nën 1000	1000-1499	1500-2499	2500-3999	4000+		
TOTALI	N	110	155	794	18,155	1,675	20,889	3291.2
	%	0.5	0.7	3.8	86.9	8.0	100.0	-

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2021



**Graf.7. Përqindja e foshnjave të lindura gjallë sipas grup peshave për vitin 2021**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021

Sipas grup-moshës së nënës pjesëmarrja më e lartë e të lindurve gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet me 7,780 apo (34.1%), pasojnë të lindurit gjallë nga nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 6,887 apo (30.2%). Mosha mesatare e nënave ka qenë mosha 29 vjeçe, (tab.7).

**Tab.7. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2021**

Grup mosha e nënës										Moshë mesatare
14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë		
N	1	427	3,592	7,780	6,887	3,322	690	78	6	22,830
%	0.0	1.9	15.7	34.1	30.2	14.6	3.0	0.3	0.0	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2021

Në vitin 2021 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 22,830 të lindur gjallë, 22,146 apo (97%) prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 684 apo (3%) kanë lindur binjak dhe nuk është raportuar asnjë lindje trenjak, (tab.8).

**Tab.8. Foshnje të lindura sipas numrit**

<b>Fëmijë të lindur</b>	<b>Një</b>	22,146	97.0
	<b>Binjak</b>	684	3.0
	<b>Trenjak</b>	0	0.0
	<b>Gjithsej</b>	<b>22,830</b>	<b>100.0</b>


Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2021

Në institucionet shëndetësore nga gjithsej 20,654 lindje të raportuara, 5,481 prej tyre apo (26.5%) lindje janë me prerje cezariane. Në institucionet publike, 3,975 lindje apo (19.8%) janë me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 603 lindje 462 apo (76.6%) janë me prerje cezariane, (tab.9, graf.8).

**Tab.9. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes, për vitin 2021**

Mënyra e Lindjes	N	%
<b>Lindje normale</b>	15,173	73.5
<b>Lindje me prerje cezariane</b>	5,481	26.5
<b>Gjithsej lindje</b>	20,654	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2021



**Graf.8. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes, për vitin 2021**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2021


Në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,598 apo (18.3%) e lindjeve janë me prerje cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 679 (40.1%), pason spitali i Prizrenit 1,075 apo 37.0% dhe spitali me më pakë raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariane ishte spitali i Ferizajit me 256 apo (16.2%). Spitalet private nga gjithsej 603 lindje të raportuara 462 apo (76.6%) prej tyre me prerje cezariane (tab.10).

Ecuria e lindjeve me prerje cezariane është analizuar për periudhën 2000-2021, në graf.10 shifet se lindjet me prerje cezariane kanë pësuar rritje përgjatë viteve, sidomos në vitin 2015 ishte përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane (27.3%), pason një rënie në vitin 2017, 2018 dhe prapë kemi ngritje të lehtë deri në vitin 2021. Në vitin 2021 nga gjithsej lindje 26.5% janë realizuar me prerje cezariane, në institucionet private përqindja e lindjeve të realizuara me prerje cezariane është shumë e lartë 76.5%, (tab.10, graf.9,10).

**Tab.10. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2021**


Institucioni	Komuna	Lindje me prerje cezariane	%	Gjithsej Lindje	
		N		N	
Institucionet Publike	QKUK	Prishtinë	1,598	18.3	8,732
	Spitali	Ferizaj	256	16.2	1,579
	Spitali	Gjakove	526	30.1	1,750
	Spitali	Gjilan	471	33.6	1,401
	Spitali	Mitrovica	308	19.8	1,557
	Spitali	Pejë	679	<b>40.1</b>	1,695
	Spitali	Prizren	1,075	37.0	2,906
	Spitali	Vushtrri	106	35.8	296
	Maternitete jashtëspitalore			0	0.0
Gjithsej në Institucione Publike			<b>5,019</b>	<b>25.0</b>	<b>20,051</b>
Institucionet Private	Bahceci Healthcare	Prishtinë	0	0.0	0
	Spitali Amerikan Kosove	Prishtinë	302	83.9	360
	Spitali Sirona	Prishtinë	63	71.6	88
	"European Clini" Spital privat gjinekologjik/obstetrik	Gjakovë	97	62.6	155
	"FATI IM" Spital privat gjinekologjik/obstetrik	Gjakovë	0	0.0	0
Gjithsej në Institucione Private			462	76.6	603
TOTALI			<b>5,481</b>	<b>26.5</b>	<b>20,654</b>

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2021



**Graf.9. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në dhe llojit të institucioneve shëndetësore**

Burimi: IKShPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2021



**Graf.10. Struktura e lindjeve me prerje cezariane për vitet, 2000-2021**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës

## VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

Mortaliteti infantil është një nga indikatorët e ndikimit (impaktit) sepse reflekton sistemin shëndetësor, kujdesin antenatal, natal dhe pasnatal, kulturën shëndetësore dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të vendit.


Ky indikator paraqet numrin e foshnjave të vdekura prej 0-364 ditë për 1000 lindje të gjalla për një vit në vend.

Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2021 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 100 foshnje të vdekura. Prej gjithsej 100 foshnjeve të vdekura, 64 apo (64%) janë foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 17 apo (17%) janë foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 19 apo (19%) janë foshnje të vdekura prej 1-11 muaj, (tab.11, graf 11).

**Tab.11. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës**

Foshnje të vdekura	Deri në	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
	24 orë				
N	22	42	17	19	100
%	22.0	42.0	17.0	19.0	100.0


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021



**Graf.11. Struktura e vdekshmërisë së foshnjeve sipas moshës**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021


Në vitin 2021 sipas të dhënave të ASK-së, mortaliteti infantil ishte 4.4%, kurse në vitin paraprak vlera e këtij indikatori ishte 3%, por për shkak të situatës pandemike të dhënat ishin të mangëta dhe kjo vlerë duhet të mirret me rezervë pasi që nuk pasqyron vlerën reale. Shkalla e mortalitetit infantil për periudhën 2002-2021 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare prej 0.5‰ (graf.12).



**Graf.12. Mortaliteti infantil, 2002-2021**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës për vitin 2021 është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 2.8‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.7‰ dhe mortaliteti postneonatal 0.8‰, (graf.13).




**Graf.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021



Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale 2000-2021 ka pësuar rënje me lëvizje variabile me mesatare 0.9%, (graf.14).



**Graf.14. Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale**

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve

Në vitin 2021 nga gjithsej 100 foshnje të vdekura, 57 apo 57% foshnje të vdekura janë meshkuj dhe 43 apo 43% femra. Vdekshmëria e foshnjeve sipas gjinisë, moshës së nënës nuk ka dallim sinjifikant me besueshmëri 95%, (tab.12).

Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor të nënës nga gjithsej 100 foshnje të vdekura 73 apo (73%) të nënave e martuara dhe 26 apo (26%) të nënave të pa martuara dhe 1 apo (1%) të nënës së ve, (tab.13).

**Tab.12. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës**

Modalitete		Gjithsej		Moshë e foshnjave të vdekura		
				Neonatale e hershme	Neonatale	Post neonatale
				N		
		%	100.0	64.0	17.0	19.0
1	Gjinia	Meshkuj	57	39	9	9
		Femra	43	25	8	10
2	Moshë e nënës	15 – 24	18	10	2	6
		25 – 34	57	41	8	8
		35+	25	13	7	5

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021

**Tab.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas statusit martesor të nënës**

Statusi martesor dhe niveli i edukimit të nënës		Moshë e foshnjave të vdekurve			
		Gjithsej	0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Statusi martesor i nënës	E pamartuar	26	16	4	6
	E martuar	73	47	13	13
	E ve	1	1	0	0
	E shkurorëzuar	0	0	0	0
	E panjohur	0	0	0	0
	Gjithsej	100	64	17	19
	%	100.0	64.0	17.0	19.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021

## VDEKSHMËRIA FETALE

Në vitin 2021 sipas IKShPK-së, departamentit të Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë ka qenë 116, me vdekshmëri fetale prej 5.1‰.


Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 88 vdekje fetale (75.9%) kanë ndodhë në QKUK, 26 apo (21.6%) në spitale, në maternitete jashtëspitalore 2 (1.7%) dhe institucione private nuk është raportuar asnjë rast i vdekjeve fetale, (tab.14).

**Tab.14. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2021**

Nr	Institucioni	Prej tyre të lindur pa jetë	
		N	%
1	QKUK	88	75.9
2	Spitalet e përgjithshme	26	21.6
3	Maternitetet jashtëspitalore	2	1.7
4	Institucionet publike	116	100.0
5	Institucionet private	-	-
6	<b>Gjithsej</b>	116	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2021


Sipas të dhënave të raportuara në departamentin e Statistikave Shëndetësore, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 9.9‰. Sa i përket spitaleve rajonale, spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: spitali i Pejës me 5.9‰ dhe Prizrenit me 3.8‰. Spitali i Mitrovicës dhe Ferizajit nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 2 vdekje fetale, kurse institucionet private nuk kanë raportuar asnjë vdekje fetale, (tab.14, graf.15).



**Graf.15. Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike**

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2021

Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2021 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.9%. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2021 është 5.1%, që tregon se është punuar në përmirësimin e gjendjes perinatale gjatë viteve, (graf.16).



**Graf.16. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2021**


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2021

## VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar.

Në vitin 2021 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 7.9% (vdekshmëria fetale 5.1% dhe vdekshmëria e hershme neonatale 2.8%), dallimi me vitin paraprak prej 8% është shumë i ndjeshëm.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2021 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1.0%, (graf.17).



**Graf.17. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2021**

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010

ASK, Statistikat e Vdekjeve dhe lindjeve

### Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (%) sipas moshës për vitin 2021:

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë): 2.8%.

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë): 0.7%.

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë): 0.8%.

**Tab.15. Indikatorët demografikë në Kosovë sipas komunave, 2021**

Komuna	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	8.8	6.6	0.0	2.3
Gjakovë	11.2	9.5	1.0	1.7
Glllogoc	14.5	5.4	0.0	9.2
Gjilan	14.0	12.2	1.0	1.7
Dragash	8.4	11.9	3.6	-3.5
Istog	9.8	8.7	0.0	1.1
Kaçanik	13.2	7.0	2.2	6.3
Klinë	11.8	8.4	0.0	3.4
Fushë Kosovë	17.4	7.3	1.5	10.2
Kamenicë	12.2	13.7	6.3	-1.6
Mitrovicë Jugore	14.2	9.0	2.1	5.1
Mitrovicë Veriore	5.3	12.5	0.0	-7.2
Leposaviq	4.9	8.2	0.0	-3.3
Lipjan	16.1	7.4	0.0	8.7
Novobërdë	14.6	17.0	0.0	-2.4
Obiliq	22.5	13.5	0.0	9.0
Rahovec	10.7	8.0	0.0	2.7
Pejë	10.8	8.4	0.0	2.3
Podujevë	15.5	6.5	0.0	9.0
Prishtinë	12.7	7.4	31.3	5.2
Prizren	10.3	7.7	0.5	2.6
Skënderaj	12.3	6.3	0.0	6.0
Shtime	13.8	5.8	0.0	8.0
Shtërpçë	16.3	26.1	0.0	-9.8
Suharekë	12.0	8.5	0.0	3.4
Ferizaj	14.4	7.6	2.0	6.8
Viti	10.7	7.1	0.0	3.7
Vushtrri	15.9	9.9	0.0	6.0
Zubin Potok	6.4	10.0	0.0	-3.6
Zveçan	5.3	13.6	0.0	-8.3
Malishevë	14.7	6.3	0.0	8.5
Junik	6.8	7.2	0.0	-0.5
Mamushë	14.8	4.3	0.0	10.5
Hani i Elezit	12.0	5.7	0.0	6.2
Graçanicë	10.8	19.2	0.0	-8.4
Ranillug	7.3	19.2	0.0	-11.9
Partesh	19.7	36.4	0.0	-16.7
Klllokot	11.1	14.0	0.0	-3.0
<b>Gjithsej</b>	<b>12.9</b>	<b>8.4</b>	<b>4.4</b>	<b>4.5</b>

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve, 2021

## PËRFUNDIMET

- Në vitin 2021, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 22,830 foshnje të lindura gjallë, prej tyre 478 jashtë Kosovës.
- Sipas të dhënave të Departamentit të Statistikave Shëndetësore, në vitin 2021 prej gjithsej lindjeve në Kosovë, 20,889 ishin të lindur gjallë dhe 116 të lindur vdekur.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve, të gjinisë mashkullore ishin 10,840 apo (51.9%), femra 10,049 apo (47.5%), raporti gjinor në lindje ishte 1078.7 meshkuj në çdo 1,000 femra të lindura gjallë gjatë vitit 2021.
- Në institucionet shëndetësore në vitin 2021 nga gjithsej lindje 26.5% të lindjeve janë kryer me prerje cezariene.
- Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 11,184 apo 46.5%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 8,732 lindje apo 42.3%, në maternitete 135 lindje apo 0.7%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Clinic dhe Fati im) 603 lindje apo 2.9%. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 20,051 apo 97.1%.
- Sipas komunave më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,780 apo (12.2%), komunën e Prizrenit me 1,989 apo (8.7%) dhe komunën e Ferizajit me 1,523 apo (6.7%). Komunitat me numrin më të vogël të të lindurve gjallë ishin komuna e Ranillugës me 27 (0.1%), Killokotit 30 apo (0.1%), Parteshit 33 apo (0.1%).
- Lindshmëria gjatë viteve 2000-2021 tregon trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.77%.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së me 23.9 lindje, pason Prizreni me 8.0 lindje, Gjakova me 4.8 lindje dhe më së paku lindje në Vushtrri me 1 lindje në ditë.
- Të porsalindurit sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2500-3999g me 86.9 % dhe grup pesha më pak se 1000g me 0.5% me pjesëmarrje më të vogël në lindje. Pështa mesatare e të porsalindurve gjallë ishte 3291.2.
- Moshja mesatare e nënave është mosha 29 vjeçare.  
Në institucionet shëndetësore nga gjithsej 20,654 lindje të raportuara, 5,481 prej tyre apo (26.5%) lindje janë me prerje cezariene. Në institucionet publike, 5,019 lindje apo (25.0%) janë me prerje cezariene ndërsa në institucionet private nga gjithsej ( 603) lindje prej tyre 462 apo (76.6%) janë me prerje cezariene. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 679 (40.1%), pason spitali i Prizrenit 1,075 apo 37.0% dhe spitali me më pakë raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariene ishte spitali i Ferizajit me 256 apo (16.2%).
- Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2021 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 100 foshnje të vdekura.
- Prej gjithsej 100 foshnjave të vdekura, 64 apo (64%) janë vdekje neonatale të hershme (foshnje të vdekura 0-6 ditë), 17 apo (17%) janë vdekje neonatale të vonshme (foshnje të vdekura 7-27 ditë) dhe 19 apo (19%) janë vdekje postneonatale (foshnje të vdekura 1-11 muaj).

- Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 2.8‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.7‰ dhe mortaliteti postneonatal 0.8‰.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2021 është 4.4‰.
- Mortaliteti infantil për periudhën 2002-2021 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare 0.5‰.
- Mortaliteti infantil sipas komunave, më i larti është në komunën e Prishtinës me 31.3‰ dhe Kamenicës me 6.3‰.
- Nga gjithsej 100 foshnje të vdekura, 57 apo 57.0% foshnje të vdekura janë meshkuj dhe 43 apo 43.0% femra.
- Në vitin 2021 sipas IKShPK-së, Departamentit i Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë ka qenë 116, me vdekshmëri fetale prej 5.1‰.
- Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 88 vdekje fetale (75.9%) kanë ndodhë në QKUK, 26 apo (21.6%) në spitale, në maternitete jashtë spitalore 2 (1.7%) dhe institucione private nuk është raportuar asnjë rast i vdekjeve fetale.
- Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2021 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.9‰
- Në vitin 2021 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 7.9‰.
- Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2021 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare 1.0‰.



## REKOMANDIMET

- Urgjentisht në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të zbatohet në praktikë pyetësi i unifikuar për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Urgjentisht të sigurohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të fuqizohet qasja multidisciplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths”.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike relevante dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të planifikohet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të zgjerohet programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë në të gjitha komunat e Kosovës.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të organizohen takime të rregullta profesionale multidisciplinare për të prezantuar dhe diskutuar çështjet për kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës.
- Të përforcohet koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të autoriteteve qeveritare shëndetësore qendrore dhe atyre lokale, organizatave qeveritare dhe joqeveritare si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, asociacioneve të tjera profesionale dhe shoqërisë civile.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.
- Të përkrahet edukimi shëndetësor për shtatzënat, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.

## **BIBLIOGRAFIA**

1. IKSHPK, Raporti i lindjeve në institucionet shëndetësore për vitin 2021, Lindjet 2021
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2021
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve në Kosovë, 2021
4. Raporti i gjendjes perinatale, 2010
5. Raporti i gjendjes perinatale, 2012

## ANEKS

### Të dhënat demografike, 2021-Kosovë

Komuna	Banorë	Lindur gjallë	Vdekur	Vdekje më pak se 1 vit	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	42,490	376	279	0	8.8	6.6	0.0	2.3
Gjakovë	92,827	1,044	885	1	11.2	9.5	1.0	1.7
Glllogoc	60,721	882	325	0	14.5	5.4	0.0	9.2
Gjilan	73,518	1,027	900	1	14.0	12.2	1.0	1.7
Dragash	33,482	281	399	1	8.4	11.9	3.6	-3.5
Istog	41,119	404	359	0	9.8	8.7	0.0	1.1
Kaçanik	34,667	459	241	1	13.2	7.0	2.2	6.3
Klinë	40,175	474	339	0	11.8	8.4	0.0	3.4
Fushë Kosovë	39,257	685	285	1	17.4	7.3	1.5	10.2
Kamenicë	26,166	318	359	2	12.2	13.7	6.3	-1.6
Mitrovicë Jugore	68,238	968	617	2	14.2	9.0	2.1	5.1
Mitrovicë Veriore	11,882	119	148	0	5.3	12.5	0.0	-7.2
Leposaviq	12,881	63	105	0	4.9	8.2	0.0	-3.3
Lipjan	57,457	926	426	0	16.1	7.4	0.0	8.7
Novobërdë	7,070	103	120	0	14.6	17.0	0.0	-2.4
Obiliq	17,264	389	233	0	22.5	13.5	0.0	9.0
Rahovec	55,391	593	443	0	10.7	8.0	0.0	2.7
Pejë	97,271	1,047	821	0	10.8	8.4	0.0	2.3
Podujevë	80,522	1,246	521	0	15.5	6.5	0.0	9.0
Prishtinë	219,017	2,780	1,631	87	12.7	7.4	31.3	5.2
Prizren	193,806	1,989	1,485	1	10.3	7.7	0.5	2.6
Skënderaj	52,586	646	329	0	12.3	6.3	0.0	6.0
Shtime	26,954	373	157	0	13.8	5.8	0.0	8.0
Shtërpcë	6,503	106	170	0	16.3	26.1	0.0	-9.8
Suharekë	56,366	674	481	0	12.0	8.5	0.0	3.4
Ferizaj	105,663	1,523	800	3	14.4	7.6	2.0	6.8
Viti	47,473	510	335	0	10.7	7.1	0.0	3.7
Vushtrri	61,014	972	605	0	15.9	9.9	0.0	6.0
Zubin Potok	6,605	42	66	0	6.4	10.0	0.0	-3.6
Zveçan	7,192	38	98	0	5.3	13.6	0.0	-8.3
Malishevë	55,878	824	351	0	14.7	6.3	0.0	8.5
Junik	6,359	43	46	0	6.8	7.2	0.0	-0.5
Mamushë	5,810	86	25	0	14.8	4.3	0.0	10.5
Hani i Elezit	10,111	121	58	0	12.0	5.7	0.0	6.2
Graçanicë	12,158	131	233	0	10.8	19.2	0.0	-8.4
Ranillug	3,698	27	71	0	7.3	19.2	0.0	-11.9
Partesh	1,675	33	61	0	19.7	36.4	0.0	-16.7
Klllokot	2,705	30	38	0	11.1	14.0	0.0	-3.0
jashte Kosove		478	55	0			0.0	
<b>Gjithsej</b>	<b>1,773,971</b>	<b>22,830</b>	<b>14,900</b>	<b>100</b>	<b>12.9</b>	<b>8.4</b>	<b>4.4</b>	<b>4.5</b>

Burimi : ASK, Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2021